



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

**Numri i lëndës:** 2019:266972  
**Datë:** 28.12.2021  
**Numri i dokumentit:** 02558674

**A.nr.1670/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me zyrtaren ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ të paditësit, A....S....., Rr. "S... S....", Komuna K..., te cilin e përfaqëson me autorizim Z.... S.... kundër të paditurës, M....P...M...S....., T.... E.... i L.... të P.... në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 08.12.2021, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Aprovohet** kërkesëpadia e paditësit A....S....., nga K..., **si e bazuar**.

**II. Anulohet** vendimi me numër të protokollit 280/2019 i datës 08.05.2019, i të paditurës M....P...M...S....., Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e padituri.

**III.** Secila palë i bartë, shpenzimet e veta.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse, në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë-kthesa e dt.15.11.2021).

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, kërkojmë nga gjykata që të aprovohet kërkesë padia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës i dt. 08.05.2019 për paditësin A....S..... E njoftojmë gjykatën se në momentin kur është larguar paditësi nga puna, jemi drejtuar inspektoratit të punës në G..., ku inspektorati i punës merr një vendim pozitiv që paditësin t'a kthejë në vendin e punës. Komuna ankohet ne organin e shkallës së dytë në Inspektoratin e Punës në Prishtinë, IP ne Gjilan merr një vendim tjetër që ai përsëri të kthehet në punë. Kryetari i komunës nuk deshti t'a zbatojë ligjin, dhe ne kemi paditë përmes gjykatës që ai të kthehet në punë dhe kërkojë nga gjykata që të obligohet organi

i shkallës së dytë që paditësin t'a kthej në vendin e tij të punës, që kur e kemi marrë përgjigjen negative nga Inspektorati i Punës në Prishtinë. Gjithashtu edhe raporti i auditimit ka treguar që largimet nga puna janë bere ne mënyrë të pa drejtë, dhe kjo vërtetohet me raportin e auditimit me nr. 22.35.1/2018-08." Më tej, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në fjalën përfundimtare, kërkon nga gjykata që të aprovohet kërkesë padia e paditësit, të anulohet vendimi kontestues i të paditurës dhe të merret një aktgjykim i bazuar në ligj.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 19.07.2021, ka theksuarës "I... i P... ka konstatuar se organi i shkallës së dytë i IP-së gjeti se në vendimin e kundërshtuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj pretendimi ankimor i ushtruar nga pala, në procedurë paditësi A...S.... është jo bindës dhe si i tillë refuzohet. Sepse bëjnë një arsyetim jo bindës për konstatimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e dispozitave ligjore, sepse të gjitha faktet që i përshkruan në ankesë, dhe i ka sjellë me ankesë janë fakte që i ka shqyrtuar Inspektorati i Punës si Organ i Shkallës së Parë, fakte të cilat i shqyrtoi edhe Komisioni i Organit të Shkallës së Dytë dhe vlerësoi se Inspektorati i Punës drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore, drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat i aprovoi edhe Komisioni i Organit të Shkallës së Dytë i IP-së." Më tej, e paditura e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi, si dhe i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pa bazuar duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës si të ligjshëm, respektivisht vendimi i TEIP-it, IP. Nr. 280/2019 i datës 08.05.2019.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 08.12.2021, ka administruar provat relevante: kontrata e punës për A...S.... e nënshkruar nga drejtori M... S... dhe paditësi A...S....; vendimi i datës. 19.06.2018; vendimi i datës 28.12.2018, me nr. 02-203; vendimi i datës 08.05.2019 me nr. 280/2019; ankesa e datës 23.03.2018; raporti i datës 02.04.2019; vendimi i datës 04.04.2019; vendimi i datës 19.06.2018 dhe raporti i datës 30.08.2018.

Me vendimin e I... të P..., me numër të protokollit 02/c-82, të datës 04.04.19, në lidhje me kërkesën e punëtorit A... S..., të cilit i'u është ndërprerë marrëdhënia e punës, vendoset që Komuna K... ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 8 par 1 të Ligjit 03/L-212, dhe të nenit 5 par. 1.5, par. 1.6 të rregullores për konkurse në sektorin publik, si dhe urdhërohet G...M..., drejtor i Arsimit që të shpallë konkurs të ri në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, dhe Au (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurës së konkurrimit në sektorin publik për të gjithë punëtorët e punësuar në arsimin e shkollës së mësipërme.

Me vendimin e shkallës së dytë, me numër të protokollit 280/2019, të datës 08.05.2019, refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit, këtu paditësit, dhe vërtetohet vendimi i organit të shkallës së parë me numër të protokollit 02/c-82, i datës 04.04.2019.

I pakënaqur me vendimin e lartcekur, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 15.07.2019 duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, përgjigjes në padi ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Për të vlerësuar këtë, gjykata fillimisht iu referua nenit 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, i cili përcakton se: “2. Inspektorati i punës: a)Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë. b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.c)Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm. d)Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese. e)Do t’iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje”.

Ndërsa me Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9, teksti te pika “a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin “Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë”.

Në anën tjetër, neni 79 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, përcakton se: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Sipas Ligjit për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e lëndëve nga marrëdhënia e punës sipas dispozitës së lartcekur, janë gjykatat themelore në kontest civil, varësisht nga kompetenca territoriale.

Në bazë të nenit 4 par.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Paragrafi 2,3 dhe 4 i këtij neni përcakton se: “2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.

3. Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte: 3.1. nuk tejkalon

kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin; 3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe 3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithë pranuar të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore. 4. Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t'i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik”.

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurit, Inspektorati i Punës, duhet të ushtrohet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës.

“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2 organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3 është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5 është në kundërshtim me ligjin material; 1.6 është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7 nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit”.

Gjykata konsideron se, në këtë rast, e paditura ka tejkaluar kompetencat e veta të cilat i ka te përcaktuar në ligj (kompetencë kjo ekskluzive e gjykatës në kontest civil) dhe si rezultat, vendimin e saj e bën të padrejtë dhe të paligjshëm, për shkak se nuk janë respektuar rregullat e procedurës që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë mënyrë, vendimi konsiderohet se përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave ligjore, të cilat pamundësojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit ose edhe vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, andaj, gjykata konform nenit 43.2 të LKA-së, vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si në pikën II të aktgjykimit.

Kjo edhe për faktin se me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, konkretisht nenin 4.1 të të njëjtit, i cili përcakton kategoritë e punonjësve të publik të cilët nuk janë pjesë të shërbimit civil, parashihet se: “në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët

poligor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjitha ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i presidentit, kryetarit të kuvendit, kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës, rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me Marrëveshje Kolektive ose me Rregullore Sektoriale”.

Paditësi si, ku themelimi dhe ndërprerja e punës se punonjësve te saj rregullohet me Ligjin e Punës dhe aktet e brendshme te saj ne ketë kuptim sipas vlerësimit te kësaj gjykate për vendosje të çështjes kontestuese, është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Themelore në kontest civil.

Në këtë mënyrë, kjo gjykatë nuk mund të vendosë vet çështjen në mënyrë meritore (të vlerësojë nëse paditësi i ka respektuar dispozitat ligjore gjatë procedurës së ndërprerjes se marrëdhënies se punës punonjësit ), pasi që kjo del jashtë kompetencave të saj, pasi është kompetent vetëm për shqyrtimin padive ne konflikt administrativ për kategorinë e shërbyesve civilë nga marrëdhënie e punës.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura lidhur me tejkalimin e kompetencës se tij , të merr aktvendim të drejtë, te bazuar, udhëzues për palën e interesit në mbrojtje juridike dhe palët të njoftohen me kohë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, dhe 38 si dhe Nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**  
**A.nr.1670/19 data 08.12.2021**

Zyrtare ligjore  
Besë Sylaj

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.